




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-7129/24 datë:19.03.2024



Npi – 01/122 datë: 28.03.2024

Bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), si dhe neni 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Si dhe në mbështetje të nenit 6 dhe nenin 10 pika 2 të Rregullores Komunale për Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Medaljet, Mirënjohjet dhe Falënderimet, Npi – 01/173, të datës 27.5.2009; Të nxitur nga nevoja për ndarjen e titullit “Sakrifica e Reçakut 1999” për personalitetet që kanë dhënë kontribut domethënës për luftën për liri në përgjithësi dhe për Masakrën e Reçakut në veçanti, si dhe duke respektuar procedurat e akteve ligjore dhe nënligjore, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e mbajtur më: 28.03.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

**PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONIT PËR NDARJEN E TITULLIT
“SAKRIFICA E REÇAKUT 1999”**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në Seancën e -I-II- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 28.03.2024, unanimisht formoi Komisionin për ndarjen e titullit “Sakrifica e Reçakut 1999” në Komunën e Shtimes, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve si vijon:

1. Adnan Ademi – I emëruar nga Kryetari i Komunës (Anëtar i Komisionit)
2. Sanije Sadiku – Përfaqësuese e Kuvendit nga pozita (Anëtar i Komisionit)
3. Rexhep Gashi – Përfaqësues i Kuvendit nga opozita (Anëtar i Komisionit)
4. Ruzhdi Jashari – Nga Shoqatat e dala nga Lufta e UÇK-së (Anëtar i Komisionit)
5. Adem Ramadani – Nga Shoqëria Civile (Anëtar i Komisionit)

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, Npi-01/108 datë: 26.03.2024.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb - faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi